



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:027212

Datë: 10.03.2022

Numri i dokumentit: 02794642

P.nr.10/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse, Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit F.K., për shkak të veprës penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1, nënpar. 1.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.258/2022 (2022:0009883), të datës 02.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 08.03.2022, në praninë e prokurorit të shtetit Danijela Batkovic, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, Av. Sabit Pllana, më datë 09.03.2022 e shpalli publikisht, ndërsa më datë 10.03.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.K., nga i ati N., e ëma S., e vajzërisë S., “data e lindjes”..., në komuna e Mitrovicës, ku edhe tani jeton, me numër personal..., i papunë, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në masën e paraburgimit nga data 10.02.2022.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datë 24.01.2022, në intervalin kohor mes orës 03:00 deri 05:00, në komuna e Zubin Potokut, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka marr pasurinë e tjetrit, ashtu që ka shkuar te shitorja - minimarketi pronë e të dëmtuarit N.C., dhe me një mjet të përshtatshëm e ka thyer drynin me të cilin ka qenë e mbyllur raftet për ftohje dhe nga aty ka marr disa kanaçe dhe pije joalkoolike Redbull, e pastaj me një mjet të përshtatshëm e ka thyer derën e lokalit dhe nga aty ka marr cigare të markave të ndryshme, si: Winston, Eva-slim, Palmall, marlboro, Davidov si dhe një shumë të papërcaktuar të të hollave, me çka ka shkaktuar dëm material prej 1.200,00 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 41, 43, 69, 71, 72, e 315 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
2. Dënim me gjobën në shumën prej 500 € (pesëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtuqë dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Në dënimin e shqiptuar me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë, nga data 10.02.2022 e tutje.
4. Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Obligohet i akuzuari që të dëmtuarit, N.C., t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 1.200 (njëmijë e dyqind) euro, në afat prej gjashtë (6) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. Të akuzuarit i vazhdohet masa e paraburgimit nga data 09.03.2022 e deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi, po jo më gjatë se dënimi i shqiptuar më këtë Aktgjykim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.258/2022 (2022:0009883), të datës 02.03.2022, kundër të pandehurit F.K., për shkak të veprës penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1, nënpar 1.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se këtë e kam bërë shkak që kam qenë në borxhe dhe nuk kam pasur rrugë tjetër, nuk e përsëris këtë veprë, andaj e lus gjykatën që ta marrë parasysh rrethanat lehtësuese.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lëndës mbi bazën e të cilën është ngritur aktakuza, prandaj i propozoj Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti i oficerit, datë 10.02.2022; Deklarata e të dëmtuarit N.C. dhënë në polici, datë 24.01.2022; Deklarata e dëshmitares M.K. dhënë në polici; Deklarata e dëshmitares L.M. dhënë në polici; Fotografitë nga vendi i

ngjarjes. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1, nënpar. 1.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në shtatë (7) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana rënduese në rastin konkret nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje, gjendjen ekonomike, ashtu që i njëjti rezultoi i pa punë, rrethanat personale dhe karakteri i të pandehurit, duke marrë parasysh se i njëjti jeton vetëm, pa një punë stabile dhe pa të ardhura të sigurta.

Gjykata, sa i përket dënimit me burg, në kuptim të nenit 71 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenit 71 par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 3 vjet, dënimi mund të zbutet deri në 1 vit, çka në rastin konkret Gjykata ka shqiptuar dënim me dy vjet burg.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg dhe dënimi me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par 1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi me të cilin cenohet pasuria e tjetrit.

Gjykata, të pandehurit kohen e kaluar në masen e paraburgimit nga data 10.02.2022 e tutje, ia llogariti në dënimin e shqiptuar me burgim, në bazë të dispozites ligjore nga neni 79 par.1 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e ekspertizës dhe

shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të pikës 5 të këtij aktgjykimi, ashtu që e ka obliguar të akuzuarin t`ia kompensojnë të dëmtuarit shumë prej 1.200 euro. Kjo për arsyen se, me rastin e pranimit të fajësisë i akuzuari e ka pranuar në tërsi fajësinë sipas aktakuzës, e ku në dispozitivin e saj ka qenë e cekur edhe shumë e dëmit prej 1.200 euro. Andaj, në këtë mënyrë është vërtetuar në tërsi gjendja faktike si në aktakuzë ku është vërtetuar edhe dëmi i shkaktuar.

Gjykata, ka vendosur si nën pikën 6 të këtij Aktgjykimi, ashtu që të pandehurit ia ka vazhduar masën e paraburgimit nga data 09.03.2022, ku në lidhje me këtë ka nxjerr aktvendim të veçantë ku edhe i ka dhënë të gjitha arsyet për vazhdimin e kësaj mase.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.10/2022, datë 10.03.2022
2022:027212, 10.03.2022

Procesmbajtësja:
Atdhetare Bashota Krasniqi

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.